



Financuar nga
Bashkimi Evropian

ZBATIMI I SË DREJTËS SË PUNËS NË KOMUNAT E ISTOGUT DHE KLINËS

Prill 2023,



Rreth nesh:

OJQ Zana është themeluar në vitin 2002. OJQ ZANA është një organizatë jofitimprurëse, jopartiake që synon të forcojë dhe promovojë një qytetari aktive; përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike. OJQ Zana angazhohet për të rritur transparencën, përgjegjësinë dhe llogaridhënien e zyrtarëve politikë dhe publikë ndaj qytetarëve.

OJQ Zana është përfituese e projektit “Të drejtat e punëtorëve përgjegjësi shoqërore” e cila financohet nga Bashkimi Evropian përmes ATRC dhe BIRN Kosova. OJQ Zana përmes këtij projekti synon të kuptoj se sa i njohin të drejtat e tyre të punës të punësuarit në sektorin privat të evidentojë qartë cilat janë të drejtat që më së shumti ju shkelen punëtorëve duke targetur specifikisht dy komuna të Kosovës; Klinën dhe Istogun si dhe të i ndërgjegjësoj punëtorët për raportimin e shkeljes së të drejtave të tyre tek organet gjegjëse siç është Inspektorati i Punës.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OJQ Zana dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, ATRC apo BIRN.

Përmbajtja

I.	Përmbledhja Ekzekutive	5
II.	Hyrje.....	6
III.	Metodologjia.....	8
IV.	Të gjeturat nga anketa.....	9
1.	Të dhënat e të anketuarve	9
2.	Sa e njihni Ligjin e Punës.....	9
3.	Sektorët ku punoni	10
4.	Kohëzgjatja në një vend pune.....	11
5.	Marrëdhënie e punës kontraktuale me shkrim.....	11
6.	Kohëzgjatja e kontratës.....	12
7.	Paga mujore	13
8.	Mënyra e pagesës	14
9.	Orari i punës.....	14
11.	Pagesa për orët shtesë të punës.....	15
12.	Pushimi i drekës.....	16
13.	Pushimi vjetor.....	16
14.	Pajisjet për mbrojtje në punë.....	17
15.	Lëndimet në vendin e punës.....	18
16.	Kompensimi për shkak të lëndimit në punë	19
17.	Njohuri për Inspektoratin e Punës.....	19
18.	Ankesa tek Inspektorati i Punës.....	20
V.	Konkluzione dhe rekomandime	21
	Rekomandime:	22
	Shtojca 1.	23
	Pyetësi	23

I. Përmbledhja Ekzekutive

Ligji i Punës është ligji bazë që garanton të drejtat minimale të të punësuarve në sektorin privat dhe publik (përveç shërbyesve civilë që rregullohen me ligj të veçanet). Ligji ka hy në fuqi në vitin 2010 dhe qysh atëherë përkundër disa iniciativave, nuk është plotësuar apo ndryshuar asnjëherë. Ndonëse Ligji garanton të drejtat bazë të punëtorëve, këto të drejta në vazhdimësi janë shkelur në Kosovë, e sidomos në sektorin privat. Përmes këtij raporti, që është përmbledhje e anketës së realizuar gjatë muajit mars në dy komuna: Istog dhe Klinë, OJQ Zana, vë në dukje shkeljet më të shpeshta të të drejtave të punëtorëve, në veçanti të punëtorëve gra në dy komuna: Istog dhe Klinë. Raporti pasqyron njohuritë që kanë punëtorët për të drejtat e tyre të garantuara me ligj dhe cilat nga këto të drejta më së shumti u shkelen punëtorëve, sidomos në sektorin privat.

Të gjeturat e raportit kanë treguar se përkundër se ka një bazë solide ligjore që rregullon të drejtat e punëtorëve, këto të drejta nuk respektohen siç është e përcaktuar me ligjet në fuqi. Ndër të drejtat e punëtorëve që më së shumti shkelen nga punëdhënësi, anketa ka treguar se janë orari i punës dhe kompensimi për lëndimet që shkaktohen në vendin e punës. Shqetësuese gjithashtu mbetet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse në vendin e punës, ku edhe atëherë kur këto pajisje sigurohen nga punëdhënësi janë vet punëtorët që nuk i përdorin ato rregullisht. Raporti po ashtu zbulon të gjeturat për njohuritë që kanë punëtorët për rolin e Inspektoratit të Punës dhe sa i drejtohen këtij Institucioni kur të ju shkelen të drejtat e tyre të punës. Ndonëse punëtorët kanë njohuri për Inspektoratin e punës, ata nuk i drejtohen këtij institucioni për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga ky institucion. Prandaj si konkluzion raporti nxjerr se Inspektorati i Punës duhet të bëjë më shumë për të rristur besimin e të punësuarve për të ju drejtuar këtij institucioni kur të drejtat e tyre shkelen nga të punësuarit. Po ashtu një punë më e madhe duhet të bëhet në vetëdijesimin e punëtorëve sidomos në përdorimin e mjeteve mbrojtëse në vendin e punës për të parandaluar lëndimet në vendin e punës.

II. Hyrje

Republika e Kosovës e ka një kornizë mjaft të mirë sa i përket rregullimit të të drejtave të punëtorëve, ndonëse shumë nga këto ligje nuk janë ndryshuar apo plotësuar për më shumë se një dekadë. Ligji i punës, i cili është ligji bazë që garanton të drejtat minimale të punëtorëve, ka hyrë në fuqi në vitin 2010 dhe qysh atëherë nuk është ndryshuar përkundër se ka pas iniciative për plotësim - ndryshimin e tij. Përveç Ligjit të punës edhe një varg ligjesh tjera që garantojnë të drejtat e punëtorëve siç janë:

Ligji Nr. 04/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-200 për Grevat, i miratuar me 06.09. 2012 . Ky ligj ka për qëllim njohjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave për organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në grevë, sipas ligjeve të aplikueshme dhe standardeve ndërkombëtare.

Ligji Nr. 04/-L-011 për organizimin sindikal në Kosovë, është miratuar me 28.07.2011 nga Kuvendi I Kosovës. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë dhe të përcaktojë të drejtat dhe liritë e të punësuarve për themelimin dhe organizimin e lirë dhe vullnetar në organizata sindikale në sektorin publik dhe privat, me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve nga puna dhe marrëdhënia e punës.

Ligji Nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë është miratuar me 16.05.2013 - Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë.

Ligji Nr.2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit e Ambientit të Punës është miratuar me 09.10.2003 - Qëllimi i Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, është që të parandalohen lëndimet në punë, sëmundjet profesionale në vendin e punës dhe të mbrohet ambienti i punës.

Përkundër legjislacionit relativisht të mirë që garanton mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, për fat të keq në Kosovë vazhdojnë të shkelen të drejtat e punëtorëve. Edhe pandemia Covid 19 ndikoj edhe më shumë që punëtorëve të ju shkelen të

drejtat e tyre. Raporte të ndryshme të publikuara kryesisht nga Sindikatat dhe Organizatat joqeveritare kanë theksuar se shumë punëtorë e humbën vendin e punës për shkak të pandemisë, duke mos marrë asnjë lloj kompensimi nga punëdhënësit e tyre. Kjo mbetet njëra nga arsyet kryesore që ka ndikuar që shumë qytetarë të Kosovës e veçanërisht të rinj, të kërkojnë mundësitë për të ikur nga Kosova me arsyet e vetme gjetjen e një vendi pune të dinjitetshëm për ta.

OJQ Zana përmes një anketë të zhvilluar në komunat e Klinës dhe Istogut ka synuar të mësojë se sa po respektohen të drejtat e punëtorëve, me theks të veçantë të punëtorëve gra.


III. Metodologjia

OJQ Zana ka zhvilluar një anketë me 18 pyetje gjysmë të hapura me 120 të anketuar, 60 prej tyre nga komuna e Klinës dhe 60 nga komuna e Istogut. Në kompanitë që kanë pasur më shumë se dhjetë të punësuar janë intervistuar nga dy të anketuar ndërsa në kompanitë më të vogla nga një. Gjithsej janë intervistuar të punësuar në mbi 40 kompani të ndryshme, 2 institucione të pavarura dhe 6 institucione shtetërore. Anketa është kryer nga dy anketues në takime të drejtpërdrejta me të anketuarit, në javën e dytë të marsit prej datës 10 deri 15. Identiteti i të anketuarve nuk është identifikuar përveç moshës së tyre. Për shkak të theksit të veçanët të përfshirjes së punëtoreve gra, gjatë përzgjedhjes së bizneseve janë përzgjedhur ato që punësojnë kryesisht gra, siç janë marketet, dyqanet, restorantet dhe floktaret, ndërsa brenda ndërmarrjeve punëtoret e intervistuar janë zgjedhur me metodën e rastësisë.

IV. Të gjeturat nga anketa

1. Të dhënat e të anketuarve


Mosha mesatare e të anketuarve nga komuna e Istogut është 30.7, ndërsa nga komuna e Klinës është 29. Ndërsa gjinia e të anketuarve në të dyja komunat është e njëjtë; 33% të të anketuarve janë burra ndërsa 67% janë gra dhe vajza.



2. Sa e njihni Ligjin e Punës

Shumica e të anketuarve nga të dy komunat kanë deklaruar se kanë njohuri të pjesëshme për ligjin e punës. Afërsisht njohuritë për ligjin e punës janë të njëjta, me një dallim të vogël të numrit të atyre që nuk kanë njohuri për ekzistencën e ligjit të punës në komunën e Istogut ku përqindja është më e lartë, pra 17% të të anketuarve, përderisa në Klinë ky numër është përgjysmë më i vogël, 8% të të anketuarve.


Sa e njihni Ligjin e Punës?



3. Sektorët ku punoni


Numri më i madh i të punësuarve, sidomos grave dhe vajzave është në sektorin e tregtisë, gjegjësisht në supermarkete dhe dyqane të rrobave. Një numër po ashtu i rëndësishëm i grave është i angazhuar edhe në sektorin e gastronomisë, ndërsa në fushën e shërbimeve dominonë sektori i bukurisë gjegjësisht floktareve. Në këtë sektor ka një numër të grave që janë edhe të vetëpunësuar apo pronare biznesi, por në hulumtim janë përfshirë vetëm ato punëtore që kanë një kontratë punë me punëdhënësit duke marr parasysh se punëdhënësit dhe të vet punësuarit nuk janë subjekt i ligjit të punës.

Sektorët ku punoni?



4. Kohëzgjatja në një vend pune


Nga përgjigjet e marra në pyetjen se që sa kohë punoni në këtë vend punë, vërehet se ka filluar një lloj stabiliteti i punëtorëve në tregun e punës, pasi shumica më e madhe e të punësuarve punojnë më shumë se 5 vite në vendin e njëjtë të punës. Një qëndrueshmëri më e lartë është vërejtur tek të punësuarit në komunën e Istogut ku 40 % e të punësuarve punojnë me gjatë se që pesë vite në vendin e njëjtë të punës, ndërsa në Klinë numri i më madh i të punësuarve 64% kane deklaruar se punojnë më gjatë se një në vendin e njëjtë të punës. Në komunën e Istogut vërehet se një numër më i madh i të punësuarve janë punësuar vitin e fundit, pra kanë më pak se një vit të punësuar.



5. Marrëdhënie e punës kontraktuale me shkrim

Ndër të gjeturat më pozitive të anketës së zhvilluar në dy komunat, Istog dhe Klinë, është se në vitet e fundit është rritë numri i të punësuarve që kanë të lidhura kontrata me shkrim me punëdhënësit. 85% në Istog respektivisht 92% në Klinë nga të anketuarit kanë deklaruar se kanë kontratë të lidhur me shkrim. Megjithatë mbetet shqetësues fakti se ende ka të punësuar që nuk kanë kontrata me shkrim, 15% në Istog dhe 8% në Klinë. Kjo nënkupton se këta punëtorë janë shumë më të predispozuar të ju shkelen të drejtat e punës. Përveç se këta të punësuar nuk paguajnë tatim në të ardhura personale, që d.m.th nuk kontribuojnë në buxhetin e


shtetit, ata nuk i gëzojnë disa të drejta që burojnë nga ligjet tjera të zbatueshme në Kosovë siç është p.sh. trusti pensional që është edhe obligim i punëdhënësit.



6. Kohëzgjatja e kontratës


Rezultatet e anketës tregojnë se shumica e të punësuarve kanë kontrata kryesisht një vjeçare. Në komunën e Istogut vërehet se ka një përqindje të madhe të njerëzve .45%, që kanë kontrata mbi 3 vjeçare, por në të njëjtën kohë në krahasim me Klinën ka më shumë kontrata që janë afatshkurtra, pra tre mujore. Ndërsa në Klinë numri më i madh i të anketuarve kanë kontrata të shkruara për një periudhe mes 1 dhe 3 vjeçare, ndërsa numri i atyre që kanë kontrata më gjatë se tri vjeçare është vetëm 25%.

Ky është një tregues se në Kosovë ka ende pa siguri për vendin e punës duke pas parasysh se më shumë se gjysma e të anketuarve kane kontrata me afat te kufizuar për më pak se tri vjet.



7. Paga mujore

Pjesa dërmuese e të punësuarve në dy komuna, Istog dhe Klinë, kanë një pagë që mesatarisht sillet prej 200 deri 400 euro. Vetëm 18% në Istog dhe 14% në Klinë kanë paga më të larta se 400 euro ndërsa numri i atyre që kanë paga mbi 500 euro është relativisht i ultë, 8% në Istog dhe vetëm 5% në Klinë. Duke pas parasysh se numri më i madh i të anketuarve ka qenë gra dhe vajza, mund të supozojmë se gratë dhe vajzat paguhen me një mesatare prej 300 deri 400 euro në muaj.




8. Mënyra e pagesës

Mënyra më e rëndomtë e pagesës së pagës është përmes transferit bankar, pra 80% respektivisht 82% deklarojnë se paguhen përmes bankës dhe 20% respektivisht 18% e marrin pagën me para në dore. Pagesa me para në dorë mund të përdoret për të ju shmangur tatimeve por edhe pagesës së trustit pensional e që kjo është një e drejt e shkelur e punëtorëve por edhe një pamundësi për të siguruar një pension solid në kohën kur të dalin në pension dhe si rrjedhojë të vazhdojnë të mbeten barrë e familjes apo e shtetit.



9. Orari i punës

Ndonëse Ligji i Punës parasheh se orari i rregullt i punës është 40 orë në javë, shumica dërmuese e të anketuarve, 87 % punojnë 48 ore në javë duke e konsideruar këtë si orar të rregullt të punës. Për më tepër një pjesë e të punësuarve punojnë edhe mbi 50 orë në javë, 3% e të anketuarve në Istog dhe 9% në Klinë




10. Pushimi i lehonisë

Vetëm 3 nga të anketuarat (5%) kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë. Nga to njëra e ka shfrytëzuar pushimin 3 muaj, njëra 6 dhe njëra 9 muaj.

11. Pagesa për orët shtesë të punës

Një nga të dhënat më shqetësuese e dalë nga anketa, sidomos për të punësuarit nga komuna e Istogut, është se 40% e tyre kanë deklaruar se nuk paguhen për orët shtesë që punojnë jashtë orarit të rregullt të punës. Kjo shifër është dukshëm më e vogël për të anketuarit nga komuna e Klinës ku vetëm 8% kanë deklaruar de nuk paguhen për orët e punuara shtesë jashtë orarit të punës.


A paguheni për orët jashtë orarit të punës?



12. Pushimi i drekës

Në përgjithësi e drejta e punëtorëve për një pushim të drekës gjatë orarit të punës respektohet. Të gjithë të anketuarit gëzojnë të drejtën e pushimit, shumica dërmuese, mbi 90% e të anketuarve, këtë pushim e kanë 30 minuta, ndërsa një pjesë e tyre rreth 9 % pushimin e drekës e ka një orë.


Pushimi i drekës



13. Pushimi vjetor

Në përgjithësi e drejta e punëtorëve për pushim vjetor brenda vitit respektohet sipas të anketuarve nga komunat Istog dhe Klinë. Varësisht edhe nga përvoja e punës që


kanë në një vend punë, ata gëzojnë edhe numrin e ditëve të pushimit brenda vitit. Pjesa më e madhe e tyre 38% në Istog dhe 52% në Klinë kanë 15 deri 18 ditë pushimi brenda viti, ndërsa 38% e të anketuarve në Istog kanë vetëm 10 deri 12 ditë pushim kurse në Klinë janë 23% të anketuarve që gëzojnë vetëm 10 deri 12 ditë pushim. 21 % respektivisht 25 % e të punësuarve kanë më shumë se 20 ditë pushimi brenda vitit.



14. Pajisjet për mbrojtje në punë

Shumica e të anketuarve deklarojnë se i kanë pajisjet për mbrojtje në punë, por shqetësues mbetet përdorimi i tyre. Më shumë se gjysma e të anketuarve deklarojnë se i kanë mjetet e mbrojtjes në punë por i përdorin nganjëherë 42% prej tyre, ose një pjesë e tyre asnjëherë 12% gjegjësisht 8%. Të dhënat e tilla janë shqetësuese sepse shumë lëndime që ndodhin në vendin e punës ndodhin për faktin se punëtorët nuk i përdorin mjetet e tyre mbrojtëse në vendin e punës.


A i posedoni pajisjet mbrojtëse dhe të sigurisë në punë dhe a i përdorni ato?



15. Lëndimet në vendin e punës

E dhëna më shqetësuese e gjithë kësaj anketë është fakti se të punësuarave nuk ju paguhen shpenzimet për lëndimet që mund të pësojnë në vendin e tyre të punës. 91% në Istog dhe 98% në Klinë kanë deklaruar se nuk ju mbulohen shpenzimet në rast të lëndimit në vendin e tyre të punës. Duke ditë faktin se në Kosovë nuk ka as sigurim shëndetësor, kjo e bënë tejet vështirë të përballueshme për një punëtorë dhe familjet e tyre çfarëdo lëndimi në vendin e punës. Kur përgjigjet e kësaj pyetje lidhen me përgjigjet e pyetjes paraprake ku gjysma e të punësuarave nuk i përdorin pajisjet e mbrojtjes në vendin e punës, tregon se shëndeti i të punësuarave është mjaft i rrezikuar.


Nëse jeni lënduar në vendin e punës, a u janë paguar shpenzimet e shërimit?



16. Kompensimi për shkak të lëndimit në punë

Vetëm 25 e të anketuarve kanë deklaruar se kanë marr kompensim për lëndimet në vendin e punës. Kjo është një e dhënë tejet shqetësuese dhe lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien e të punësuarve në Kosovë.


A keni marrë kompensim, për shkak të lëndimit në vendin e punës?



17. Njohuri për Inspektoratin e Punës

Pjesa më e madhe e të anketuarve, 82% në Istog respektivisht 79% në Klinë e dinë se ekziston Inspektorati i Punës.


A keni njohuri për Inspektoratin e Punës?



18. Ankesa tek Inspektorati i Punës

Është shumë shqetësues fakti se përkundër se kanë njohuri për ekzistencën e Inspektoratit të Punës dhe në disa raste punëtorëve ju shkelen të drejtat e tyre të punës, ata nuk i drejtohen Inspektorit të Punës për të kërkuar realizimin e të drejtave të tyre. Vetëm 2% të anketuarve nga Istogu janë ankuar në Inspektoratin e Punës kurse asnjë i anketuar nga Klina nuk është ankuar asnjëherë tek Inspektorati i Punës.

A jeni ankuar ndonjëherë tek Inspektorati i Punës ?



V. Konkluzione dhe rekomandime

Krahasuar me raporte të publikuara më herët nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile por edhe nga vet Inspektorati i punës, vërehet një përmirësim i zbatimit të të drejtave të punëtorëve. Përmirësim vërehet në lidhjen e kontratave me shkrim dhe në respektimin e të drejtës për pushim.. Megjithatë numri i të punësuarve që punojnë pa një kontratë të shkruar mbetet ende shqetësues pasi këtyre punëtorëve ju shkelen edhe të drejta tjera që burojnë nga kontrata e punës.

Përdorimi i pajisjeve të mbrojtjes në punë në Kosovë është shqetësues, duke qenë se një numër i madh i punëtorëve nuk i përdorin ato në vendin e punës. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e të punësuarve dhe mund të çojë në lëndime serioze.

Një faktor tjetër shqetësues është që shumica e të punësuarve nuk paguhen për shpenzimet e tyre në rast se pësojnë një lëndim në vendin e punës.

Edhe pse shumica e të anketuarve kanë njohuri për Inspektoratin e Punës, niveli i ankesave tek Inspektorati është shumë i ulët. Kjo mund të jetë e lidhur me faktorë si mungesa e informacionit për të drejtat e punës dhe procedurat e ankesave, frika e rikthimit të punës ose ndëshkimit nga punëdhënësit, si dhe mungesa e besimit në Inspektoratin e Punës si një organizëm që mund të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të punës.

Rekomandime:

Inspektorati i Punës duhet të ndërmarrë masa për të inkurajuar punëtorët për të përdorur pajisjet e mbrojtjes në vendin e punës. Inspektorati i Punës duhet gjithashtu të vlerësojë mundësinë e rregullimit të ligjit për të garantuar që punëtorët paguhen për lëndimet e tyre në vendin e punës. Të gjitha këto masa duhet të ndërmerren në bashkëpunim me organizatat sindikale dhe punëdhënësit për të garantuar që të punësuarit në Kosovë kenë të drejta të barabarta në vendin e punës dhe për të mbrojtur shëndetin e tyre.

Inspektorati i Punës të ndërmarrë masa për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të punëtorëve në lidhje me të drejtat e tyre të punës dhe procedurat e ankesave. Një rritje e nivelit të besimit në Inspektoratin e Punës mund të arrihet duke u siguruar që Inspektorati të jetë i qartë dhe transparent në procesin e zgjidhjes së ankesave dhe duke promovuar dhe shpërndarë informacion lidhur me rastet e suksesshme të zgjidhjes së ankesave. Në të njëjtën kohë, Inspektorati duhet të bëjë përpjekje për të nxitur punëdhënësit për të respektuar të drejtat e punëtorëve dhe për të luftuar abuzimet në vendin e punës.

Shtojca 1.

Pyetësi

Ky aktivitet është pjesë e projektit “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të punëtorëve të grupeve të cenuara në tregun e punës” i cili zbatohet nga OJQ ZANA në partneritet Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) dhe Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN Kosova), dhe është i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është Identifikimi i shkeljeve më të shpeshta të të drejtave të punëtorëve në veçanti të grave në vendin e punës në komunat Klinë dhe Istog. Ky pyetësor është hartuar për të marrë informata rreth respektimit apo mos respektimit të të drejtave të punëtorëve dhe shkeljet më të shpeshta të këtyre të drejtave.

Të gjitha të dhënat që mblidhen përmes këtij pyetësi janë konfidenciale dhe shërbejnë vetëm për qëllim të mbledhjes së statistikave. Identiteti i të anketuarve dhe të dhënat tjera të tyre nuk bëhen publike dhe nuk ndahen me palë të treta

Pyetësor për zbatimin e Ligjit të Punës në komunën e Istogut dhe Klinës

Data dhe vendi _____

Të dhënat për të anketuarin

Mosha _____ Gjinia M F

1. A jeni të njoftuar për Ligjin e punës dhe përmbajtjen e tij?

a) shumë mirë b) pjesërisht c) nuk e di që ka një ligj të punës

2. Sektori ku punon:

a) Institucion publik: Inst. shtetror Kompani publike Inst. i pavarur

b) Kompani private: a. gastronomi b. shërbime (psh. frizere) c.
tregti (market). D. tjetër

3. Që sa kohë punoni në këtë vend pune:?

a) më pak se një vit b) 1 deri 5 vite c) më shumë se 5 vite

4. A keni kontratë të nënshkruar me punëdhënësin?

a) jo vetëm marrëveshje gojore b) po kam kontratë të shkruar

5. Sa është kohëzgjatja e kontratës?

a) 3 muaj b) 1 vjeçare c) me shumë se 3 vite

6. Sa është paga juaj mujore

a) 170- 200 b) 200-300 c) 300-400 ç) 400-500 d) Mbi 500

7. A paguheni kesh apo përmes bankës?

a) kesh b) përmes bankës c) kombinim

8. A paguheni shtesë për orët që punoni jashtë orarit të punës?

Po Jo

9. Sa orë në ditë keni pushim brenda orarit të punës?

gjysme orë një orë

10. Sa ditë në vit keni pushim me pagesë ?

a)10-12 b)15-18 c)20-22

11. Cili është orari i juaj i punës, sa orë në javë punoni ?

40 (5 ditë) b) 48 (6 ditë) c) 7 ditë

12. Sa ka zgjatur pushimi i Lehonisë (me pagesë) ? (pyetje vetëm për gratë)

a) 3 muaj b) 6 muaj c) 9 muaj

13. A i posedoni pajisjet mbrojtëse dhe të sigurisë në punë dhe a i përdorni ato?

a) nuk kemi mjete apo masa mbrojtëse të sigurisë në punë

b) i kemi, por nuk i përdorim masat mbrojtëse

c) nganjëherë i përdorim mjetet mbrojtëse

d) po çdoherë i përdorim mjetet mbrojtëse në punë

14. Nëse jeni lënduar në punë, a u janë paguar shpenzimet e shërimit ?

po jo

15. A keni marrë kompensim për lëndim në vend të punës ?

po jo

16. A jeni në dijeni për Inspektoratin e Punës?

po jo

17. A jeni ankuar ndonjëherë në Inspektoratin e Punës?

po jo